



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Datë: 28.7.2023
Vendi: Rahovec
Nr. i ref.: 04/1091

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, **rishpall:**

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës zëvendës drejtor/eshë në:

➤ **SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec**

Institucioni: Komuna e Rahovecit
Drejtoria: Drejtoria Komunale e Arsimit
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Titiulli i mbikëqyrësit: Drejtoria Komunale e Arsimit
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vite

I. Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët/et për të marrë pjesë në konkurs:

1. Kandidati/ja i/e interesuar për konkurim në vendin e punës për zëvendës drejtor/eshë shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

- 1.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsimin e përgjithshëm dhe normativit për arsimin profesional në fuqi;
 - 1.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.2.2. Master arsimor (kualifikim prej 300 ECTS/ 5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.2.3. Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - 1.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- 1.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit administrativ për licencim të mësimdhënësve;
- 1.4. Të ketë të përfunduar me sukses një program të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH, sipas rekomandimit të KSHLM;
- 1.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
 - 1.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor, për kandidatët/et për drejtor/eshë në arsimin e mesëm të lartë;
 - 1.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor, për kandidatët/et për drejtor/eshë në nivelet tjera, dhe
 - 1.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor, për kandidatët/et për zëvendësdrejtor/eshë.
- 1.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja, duhet të jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkuron.

II. Kandidati/ja duhet të posedojë dhe dëshmojë dokumentet si në vijim:

2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
 - 2.1. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 - 2.1.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master në udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
 - 2.1.2. Kopjen e dokumentit të identifikimit (ID);
 - 2.1.3. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore;
 - 2.1.4. Dëshminë se nuk jeni nën hetime dhe dëshminë se nuk keni qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
 - 2.1.5. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
 - 2.1.6. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
 - 2.1.7. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të U.A.151/2020;

- 2.1.8. Certifikatën e lindjes;
- 2.2. Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në paragrafin 1.7., të këtij neni, së bashku me formularin e aplikimit, i cili merret në DKA, dorëzohen në kopje fizike po ashtu në DKA;
- 2.3. Kandidati/ja në këtë konkurs publik, ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon;
- 2.4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendës drejtorit/eshës në IEAAP:

3. Drejtori/eshë i/e IEAAP, ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:
 - 3.1. Përgatitjen e Planit Vjetor, Planit Zhvillimor të Institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
 - 3.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informative në arsim (SMIA) dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
 - 3.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimeve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësime dhe punëtorët tjerë të arsimit;
 - 3.4. Mbështetjen dhe mbikqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
 - 3.5. Mbështetjen dhe mbikqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor si dhe mekanizmave tjerë të institucionit që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
 - 3.6. Bashkëpunimin me Këshillin Drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
 - 3.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH-së;
 - 3.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 3.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
 - 3.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsimin parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

IV. Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike, së bashku me formularin e aplikimit, në DKA. Formulari i aplikimit merret në DKA/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks.gov.net>.

V. Listaa pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 59 pikë, hynë në listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë, kanë të drejtë të punësohen.

VI. Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

VII. Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 28.8.2023 dhe zgjat 15 ditë kalendarike, me datë 11.9.2023, deri në orën 16:00.



Avni Morina

Drejtore